



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2660/1 prot.

Datë 27.08.2026

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekti: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik COLOMBO SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-92593-07-07-2026, me objekt “*Rikonstruksion me prishje dhe shtese anesore ne cerdhen "Nr. 15"*” me fond limit 40,803,295.24 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24-07-2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlore.

Ankimues: Operatori ekonomik COLOMBO SHPK me NIPT J82916489E,
Adresa: Lagjja Kryengritja e Fierit, rruga Vangjel Rrushku, godina nr.67 , Fier, Fier

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlore.
Adresa: Rr. “Sheshi 4 heronjte Bashkia Vlore”.

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/7205 datë 26.08.2026 prptokolluar me tonen 2660/2026 datë 26.08.2026 nga Operatori ekonomik COLOMBO SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-92593-07-07-2026, me objekt “Rikonstruksion me prishje dhe shtese anesore ne cerdhen "Nr. 15"” me fond limit 40,803,295.24 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 24-07-2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlore.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik COLOMBO SHPK në procedurën e prokurimit së sipërcituar.

Bazuar në nenin 112 pika 3 gërmat “b” dhe “c” të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: “3. Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, Komisioni i Prokurimit Publik publikon: **b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për**

vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

• Komisioni i Prokurimit Publik publikon arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik COLOMBO SHPK si vijon:

Dosja me Nr.305 Prot., datë 07.08.2026 me objekt “Listë dorëzimi dokumentacioni”, paraqet mangësi të dokumentacionit fizik si më poshtë: 1. Pika 2.3.3 e dst nuk është e permbushur , Nga listepagesat e Muajt “Qershor 2026” nuk është i deklaruar “Inxhinier Vladimi Kasemi” ne rolin e Ing. Materiale , pika 2.3.3 e dst nuk është e permbushur. 2. Pika 2.3.8 e dst nuk është e permbushur,nga listepagesat e Muajt “Qershor 2026” nuk është i deklaruar “Shofer Florand Cekrezi” ne rolin e shoferit . 3. Pika 2.3.9 e dst nuk është e permbushur, Mjeti i llojit “Kamioncione me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 Ton” ne pronesi me Targa “AB760BY” ka munges dokumentacioni ne paisjen me Certificate Transporti Mallrash , nga Bashkia ose Ministria e Infrastruktures dhe Energjise.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 27.08.2026

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gjergj Mersini	Donika Doci	Edvin Simo	Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu